



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës,
mbajtur më 01.02.2018, e cila filloj në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Nol Nushi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Egzon Azemi (LVV), Yll Rugova (LVV), Genc Sherifi (LVV), Adrian Berisha (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci (LVV), Vala Peshku (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Milot Podvorica (LVV), Mimoza Sylejmani (LVV), Qëndrim Sahiti (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Shefki Gashi (LDK), Agim Gashi (LDK), Sokol Havollı (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fikneta Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Drilon Pireva (LVV), Visare Gashi (LVV) dhe Uran Ismaili (PDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit.
Për këtë mbledhje u propozua ky**

Rend dite:

1. Diskutim për ndotjen e ajrit në Prishtinë.

Kryesuesi fillimisht propozoi që të gjithë shefat e grupeve parlamentare t'i mbledhin rekomandimet e grupeve të tyre parlamentare dhe pas përfundimit të diskutimeve, të harmonizohen të gjitha së bashku.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se duhet të organizohen aktivitete në nivel të komunës, e që ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndërgjegjësimin dhe vetëdijesimin e institucioneve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe qytetarëve të kryeqytetit në reduktimin e ndotjes së ajrit.

Halim Halimi, sa i përket ndotjes së ambientit në komunën e Prishtinës, shprehu mendimin se nuk i është kushtuar rëndësi e duhur, ku si pasojë e kësaj është kjo gjendje alarmante, ndërsa sa i përket gjendjes së transportit në qytet, ajo është kaotike.

Blerand Stavileci ngriti shqetësimin e njëjtë sa i përket ndotjes së ajrit në komunën e Prishtinës. Ai shprehu mendimin se përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje gjatë sezonit të dimrit, termocentralet e Kosovës, automjetet e vjetruara, trafiku i dendur, djegia e shtuar e karburanteve, djegia e mbeturinave, mungesa e sipërfaqeve të mjaftueshme gjelbëruese, mos pastrimi i rrugëve, ndërtimet gjatë vitit pa plan të mirëfilltë urbanistik, prania enorme e pluhurit në kryeqytet etj., janë shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit.

Fadil Gashi, sa i përket ndalesës së makinave në qendrën e qytetit, tha se kjo është masë afatshkurtër e cila nuk krijon zgjidhje. Ne si GP propozojmë të bëhet shtrirja e rrjetit të ngrohtores "Termokos" në të gjitha lagjet e qytetit.

Rifat Deri theksoi se ne po përballemi me një ndotje enorme të ajrit në Prishtinë. Në ndotjen e ajrit në kryeqytet, drejtpërdrejt ndikojnë termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", të cilat ende vazhdojnë të operojnë pa filtra adekuat dhe funksional, deponitë e hirit në Obiliq, rritja enorme e trafikut në Prishtinë, djegia e karburanteve fosile, siç janë druri, thëngjilli nafta etj.

Shpend Ahmeti, kryetar, tha se ekziston Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, që duhet ta bëjë matjen e cilësisë së ajrit, e cila ka bërë instalimin e disa stacione për matje e ndotjes së ajrit, ku në njëren pikë të matjes i ka shpenzuar 150 mijë euro, e që është ndoshta mjeti më i shtrenjtë për matjen e cilësisë së ajrit. Fatkeqësisht, edhe sot në 10-vjetorin e Pavarësisë, ne nuk kemi ndonjë raport nga Ministria e Mjedisit, e cila me përqindje apo me analizë shkencore na e përcakton se cilat janë burimet kryesore të ndotjes.

Sokol Havolli theksoi se trafiku po konsiderohet si një nga ndotësit më të mëdhenj të ajrit në Prishtinë. Lidhur me këtë, ai propozoi realizimin e projektit të unazës së qytetit për pjesën verilindore, pasi që një pjesë e konsiderueshme e trafikut në qytet do të shkarkohej drejt përsëdrejti, por edhe një pjesë e bizneseve mund të zhvendosen në pjesë të tjeter të qytetit. Njëherësh ai tha se është obligim i Kuvendit të Komunës që të bëjë alokimin e mjeteve financiare për ekzekutivin e Komunës, që të realizohet studimi shkencor mbi shkaktarët e ndotjes së ajrit.

Eman Rrahmani, sa i përket ndotjes së ajrit, tha se duhet të angazhohemi secili, në mënyrë që të kontribuojmë në përmirësimin e gjendjes në të cilën ndodhemi. Masat që duhen të ndërmerren në raste urgjente, siç ishte gjatë këtyre ditëve, që do të kishte efekt të menjëhershëm, do të ishte subvencionimi i ekonomive familjare për ngrohje pa thëngjill, transporti publik falas, ndalimi i përdorimit të veturave zyrtare, ndalimi i ndërtimit përkohësisht, kontrolli urgjent i cilësisë së derivateve, ndalimi i dhënieve së thëngjillit për punëtorët e KEDS-it, si dhe urgjentisht të ndryshojë zgjerimi i rrjetit të ngrrotores "Termokos".

Jonuz Salihaj, drejtorë i Drejtorisë së Arsimit, ngriti shqetësim lidhur me ndotjen e ajrit, duke thënë se duhet të ndërmerren masa urgjente për përmirësimin e gjendjes, jo në një periudhë të shpejtë, sepse ky është proces afatgjatë.

Sami Boroci theksoi se ndotja e ajrit nuk është problem aktual, i krijuar tash, por është problem i shtresuar tash e sa kohë, andaj shpresoj se tash e tutje do të ketë masa konkrete në këtë drejtim. Ai kërkoi që drejtoria përkatëse për mirëmbajtje e parqeve të konsolidohet sa më parë dhe propozoi që kjo drejtori të quhet Drejtoria e Ambientit dhe Parqeve, pra të ketë një fokus të veçantë për ambientin dhe krijimin e disa parqeve.

Shefki Gashi kërkoi që të krijohen kushte për një jetë më të mirë, një ambient më të pastër, një standard, një komunikim, një lëvizje më të mirë për qytetarët e Prishtinës. Sa i përket ndalimit të qarkullimit të automjeteve në qendër të qytetit, ai nuk e pa si zgjidhje të arsyeshme, sepse ka edhe shume faktorë të tjera që ndikojnë në ndotjen e ajrit.

Selim Pacolli, nënkyrytar, ngriti shqetësim lidhur me ndotjen e ajrit, duke thënë se ndotja ka ekzistuar gjithmonë në Prishtinë, shpeshherë edhe në nivel më të lartë. Ai tha se ne nuk kemi shpallur gjendje të jashtëzakonshme, mirëpo është një gjendje emergjente dhe mbi këto kompetenca ne kemi marrë vendim për parandalimin e shitjes së thëngjillit në masë dhe parandalimin e qarkullimit të automjeteve në qendër të qytetit, të cilat janë konsideruar si një faktor potencial i ndotjes së ajrit në kryeqytet.

Agim Gashi shprehu mendimin se nuk janë kryer detyrat elementare të qeverisë komunale dhe të kryetarit, por menjëherë kanë kaluar në politika të mëdha dhe në plane afatmesme dhe afatgjata, të cilat mund të realizohen dikur dhe mirë që janë iniciuar, por ka pasur mundësi që të merren edhe masa ditore, çoftë ato dyditore,

treditore në fushat ku ka mundësi, në mënyrë që dëmet të jenë sa më të vogla dhe kjo gjendje alarmante të zbutet aq sa është mundësia dhe të mos shkaktohen dëme aq të mëdha.

Egzon Azemi sa i përket ndotjes së ajrit, tha se është një problem jashtëzakonisht i madh dhe të gjithë qytetaret jemi te shqetësuar lidhur me këtë gjendje. Si shkaktar të ndotjes së ajrit nuk janë vetëm termocentralet apo thëngjilli, por si problem madhor konsiderohen edhe ndërtimet pa leje. Sa i përket rrjetit të ngrohtores "Termokos", është e rëndësishme që të kërkohen subvencione nga Qeveria ose nga Komisioni Evropian, që lagjet "Kodra e Trimave", "Kolovica", "Arbëria" etj., sa më parë të përfshihen në rrjetin e ngrohtores "Termokos".

Leutrim Retkoceri, lidhur me masat rreth ndalimit të qarkullimit të veturave dhe ndalesat tjera, tha se nuk janë zgjidhje e problemit me të cilin ballafaqohemi dhe nuk po i jepin zgjidhje adekuate ndotjes së ajrit. Ai propozoi që banorëve të cilët për ngrohje përdorin qymyr apo lëndë të tjera djegëse, para se t'u ndalohet përdorimi i këtyre lëndëve, duhet që t'u dilet në ndihmë në mënyra të tjera, një lloj subvencion i nga Komuna bashkërisht me Qeverinë e Kosovës.

Arbenita Murseli sa i përket ndotjes së ajrit, ajo apeloi që të bëhet një zgjidhje e menjëherëshe për të ndikuar në vetëdijesimin e popullatës. Djegia e pakontrolluar e thëngjillit të papërpunuar, mungesa e filtrave në termocentrale, deponitë e hapura të hirit, tymi i liruar nga makinat e vjetra dhe mungesa e hapësirave të gjelbra ndikuan në këtë rezultat që e kemi sot.

Ajo njëherësh kërroi që ndërmarrja "Trafikut Urban" ta respektojë orarin e qarkullimit të autobusëve.

Adrian Berisha e përgëzoi grupin punues që mori vendim për ndalimin e qarkullimit të automjeteve në qendër të qytetit. Gjithashtu ceku se në të gjitha shkollat fillore është e nevojshme mbajtja e ligjëratave nga disa organizata të ndryshme lidhur me ndotjen e ambientit. Ai kërroi që të krijohet një kampanjë vetëdijesuese e qytetarëve lidhur me këtë çështje.

Elmira Nikçi tha se sa i përket ndotjes së ajrit në kryeqendrën tonë, ajo arrin në nivelin më të rrezikshëm. Ajo kërroi të merren masa urgjente, që të mos kemi pasoja negative në dëmtimin e shëndetit të qytetarëve.

Besnik Mujeci shprehu mendimin se do të ishte i nevojshëm krijimi i një rripi të gjelbër, i cili do të shtrihet nga lagja "Kodra e Trimave", do të vazhdonte nëpër lagjen "Arbëria", deri në lagjen "Kalabria", duke vazduhar drejt lagjes "Vetërniku" dhe do të lidhet me Hajvalinë në drejtim të liqenit të Badovcit, ku hapësirat e gjelbra do të ishin arma jonë më e madhe kundër ndotjes.

Naime Osmani tha se përderisa është bërë ndalimi i qarkullimit të automjeteve, kërkoj të dijë sa ka ndikuar në zbritjen e substancave që janë ndotës kryesor të ajrit.

Faqe 4 nga 6

Ajo shprehu shqetësim për djegien e plastikës, si ndotës i madh i ajrit, dhe kërkoi nga Drejtoria e Inspektionit që rojet të kenë kujdes më të madh në mbrojtjen e pyjeve.

Fitneta Bejta kërkoi një sensibilizim te gjeneratat e reja lidhur me çështjen e mjedisit, duke kërkuar kujdes më të shtuar për shtimin e hapësirave gjelbëruese.

Vesel Makolli, gjithashtu ngriti shqetësim rreth ndotjes së ajrit, duke cekur se ndër ndotësit kryesorë janë termoelektranat, ndërsa sa u përket filtrave, nëse nuk janë duke punuar, atëherë kjo është veprë penale e menaxherëve të KEK-ut.

Sami Salihu, lidhur me vendimin që ka marrë Komuna e Prishtinës për ndalimin e qarkullimit të automjeteve, konsideroj që ka bërë një veprim të paanalizuar mirë dhe të pastudiuar. Ai kërkoi të dijë se a ka pasur efekt pozitiv ky vendim për ndalimin e qarkullimit të veturave.

Shefqet Osmani shprehu mendimin se në qoftë se vazhdon kjo ndotje e ajrit, ne si Kuvend duhet ta obligojmë ekzekutivin që të shpërndajë maska falas për nxënësit e shkollave dhe qytetarët e Prishtinës.

Pas diskutimeve të shumta, me propozimin e kryesuesit, shefat e grupeve parlamentare hartuan këtë deklaratë me këto rekomandime.

D E K L A R A T Ë :

Kuvendi i Komunës së Prishtinës e mirëpret Rezolutën e Kuvendit të Kosovës, të miratuar më 1 shkurt 2018, lidhur me gjendjen e cilësisë së ajrit, dhe zotohet se do t'i kryejë obligimet e dala nga kjo rezolutë që kanë të bëjnë me pushtetin lokal.

Kuvendi i Komunës i miratoi këto rekomandime:

1. Komuna në bashkëpunim me MMPH-në, të bëjnë studimin shkencor dhe profesional për shkaktarët e ndotjes dhe propozimin e masave për përmirësimin e gjendjes;
2. Të bëhet zgjerimi i rrjetit të ngrohiores së qytetit "Termokos" dhe të hartohet plani për ngrohjen e lagjeve të cilat nuk mund të lidhen me këtë rrjet;
3. Të hartohet programi i vetëdijesimit publik mbi ndotjen e ajrit për vitin 2018-2019;
4. Të hartohet një rregullore për shitjen dhe mënyrën e përdorimit të lëndëve djegëse në territorin e komunës së Prishtinës;
5. Të bëhet mbjellja e 50.000 drurëve;
6. Shkollat fillore dhe të mesme të zhvillojnë aktivitete vetëdijesuese, që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit;
7. Komuna në bashkëpunim me MMPH-në, të bëjnë shtimin e numrit të stacioneve matëse të cilësisë së ajrit;

Faqe 5 nga 6

8. Të bëhet shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara dhe krijimi i shtigjeve për biçikleta.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 5 abstenime, u miratuan rekomandimet e Kuvendit komunal për ndotjen e ajrit në Prishtinë.

Mbledhja përfundoi në orën 19:15.

Procesmbajtësja
Luljeta Selimi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

